

Nr.regi 62588/12

DPK/DMP

02

03-1414/13

15.05.2013

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjes, me gjyqtarin Shpend Krasniqi dhe Sek. Juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Bukurije Gjonbalaj nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 i Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 par. 1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 19.04.2013 merr këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Bukurije Zija Gjonbalaj e lindur me 04.08.1967 në Tivar, R. e Malit të Zi, Ambasadore në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë të Italisë, për kundërvajtje nga neni 7 i Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar.

Pezullimi bëhet konform neni 198 par. 1 pika 8 të LMK-së, pasi që nuk ka prova që e pandehura ka kryer kundërvajtje.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi i dorëzohet të pandehurës dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim


Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr. 01-4257/12 të datës 23.11.2012 për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurës e për kundërvajtjen e cekur më lartë.

Në bazë të kërkesës së parashtuar, Gjykata inicioj procedurën kundërvajtëse me marrjen e të pandehurës në pyetje e cila në seancën verbale gjyqësore të mbajtur me datën 28.03.2013, deklaroi se menjëherë pas marrjes së detyrës përkatësisht emrimit të saj Ambasadore në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë të Italisë, nga asistentja e saj është informuar së çfarë veprimesh duhet ndërmarrur dhe ndër të tjera nga ajo është informuar së MPJ e R. së Kosovës do ti dërgon formularët për deklarin e pasurisë. Zyrtarja e personelit të MPJ, ka dërguar shkresat përmes Email-it në emër të saj dhe së bashku me këtë dhe formularin për deklarin e pasurisë. Për dy muaj rreshtë në Ambasadë nuk ka marrur kurrfarë shkresë në emër të saj, meqenëse ekziston dhe një person tjetër me emër dhe mbiemër të njëjtë (Bukurije Gjonbalaj) e cila punon në Prokurorinë e shtetit në Prishtinë, të gjitha shkresat e dërguara gabimisht kanë shkuar në Email-adresë të saj dhe bashkë me shkresa dhe formulari për deklarin e pasurisë, shkresat nuk janë kthyer nga ajo, posa është njoftuar së me kohë nuk e ka deklaruar pasurinë ka njoftuar MPJ dhe nga ata ka kërkuar me ia dërguar formularin për deklarin të pasurisë ku posa e ka pranuar të njëjtin menjëherë e ka plotësuar dhe ia ka dërguar Agjencisë.

Gjykata me qëllim të sqarimit, plotësimit dhe verifikimit të kësaj çështje juridike, ka ftuar dhe marrur në pyetje dy dëshmitarë dhe atë;

Agron Behramin - Shef i Divizionit në Agjencinë Kundër Korrupsionit, nga deklarata e të cilit rezultoi se e pandehura pas emërimit të saj ambasadore, në kohë nuk e ka deklaruar pasurinë, nga zyrtarja kontaktuese, Agjencia është njoftuar së zyrtarët e lartë të emruar në MPJ, nga ajo në kohë janë njoftuar, lidhur me obligimin për deklarin e pasurisë, mirëpo me vonë nga zyrtarja e njëjtë janë informuar së shkresat që i janë dërguar përmes Email-it, Ambasadorës Bukurije Gjonbalaj, të njëjtat gabimisht i janë dërguar në Email adresë të njëjtë me emër dhe mbiemër të njëjtë (Bukurije Gjonbalaj) e cila nuk ka pasur për obligim deklarin e pasurisë.

Dëshmitari tjetër, Lumturije Lipoveci - Zyrtare e lartë e personelit në MPJ, deklaroi së menjëherë pas emërimit të saj ambasadore në detyrë përkatësisht pas përfshirjes së emrit të saj në sistemin e pagave, me datën 18.09.2012 përmes Email-it ia ka dërguar njoftimin së bashku me formularët për deklarin e pasurisë.



pasurisë, por nuk ka marr konfirmim nga ajo së të njëjtën e ka pranuar. Agjencia në muajn nëntor 2012 e njofton, së nuk ka pranuar njoftim nga Ambasadorja. Njoftimin që kohë më parë ia kishte dërguar ambasadorës ia vazhdon Agjencisë dhe të njëjtën ditë i shkruan Ambasadorës, duke e njoftuar dhe asistentën e saj dhe posa Ambasadorja njoftohet thërret në MPJ dhe iu thotë së është hera e parë që sot ka marr shkresë nga ata dhe së për deklarim të pasurisë nuk ka qenë në dijeni dhe kërkon sqarim së në çfarë Email adrese janë dërguar shkresat dhe pasi që i ka treguar, ajo i ka thënë së vazhdimisht ka kërkuar që t'i ndryshohet Email adresa për shkak se ekziston dhe një person tjetër me emër të njëjtë, pasi që ka verifikue adresë Book-un, ka verejtur së ekziston dhe një person tjetër me emrin Bukuriye Gjonbalaj që punon në Prokurori dhe së njoftimi së bashku me formularët për deklarim të pasurisë gabimisht janë dërguar në emër të saj. Edhe pse Email-i nuk ka qenë i dedikuar për të, ajo fare nuk e ka kthyer mbrapa.

Ambasadorja me datën 13.11.2012 pasi nga zyrtarja kontaktuese, pranon njoftimin së bashku me formularët, deklaron pasurinë dhe e dërgon në Agjencion, përmes Email adresës.

Shkresat e dërguara Ambasadorës përmes Email-it, nga zyrtarja e cekur me lartë i janë bashkëngjitur shkresave të lëndës si provë.

Andaj në rastin konkret, është i pakontestueshëm fakti së e pandehura, në kohë nuk e ka pranuar formularin për deklarim të pasurisë, edhe pse zyrtarja e personelit në MPJ në Prishtinë, në kohë ia ka dërguar, por është vërtetuar se shkresat kanë shkuar në adresë të gabuar, të një personi tjetër më emër të njëjtë dhe personi i cili i ka pranuar shkresat përmes Email adresës fare nuk i ka kthyer ato. Në rastin konkret nuk ka prova se e pandehura ka kryer veprë kundërvajtëse siç pretendon parashtruesi i kërkesës.

Andaj në mungesë të provave së e pandehura ka kryer kundërvajtje si në kërkesën e parashtruar, e në vështrim të neni 198 par. 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, ndaj të pandehurës u **PEZULLUA** procedura dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi e pandehura dhe parashtruesi i kërkesës mund të ushtrojnë ankesë e cila i adresohet Gjykatës së Apelit - Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj Gjykate e pa taksa.

VENDOSI: GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjes, me datë 19.04.2013.

GJYQTARI
Shpend Krasniqi

